



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

NJOFTIM

Për

Shpalljen e kritereve të pranimit të Personelit Akademik me kohë të Pjesshme pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, për vitin akademik 2022-2023

Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, Ligj nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” Neni 62, si dhe në Vendimin e Rektoratit të UPT-së, Nr. 116, datë 22. 09. 2020 “Për miratimin e procedurës së punësimit të Personelit Akademik të Ftuar”, departamentet e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike shpallin kriteret për pranimin e Personelit Akademik me kohë të Pjesshme, për vitin akademik 2022-2023, si më poshtë:

I. DEPARTAMENTI I INXHINIERISË MATEMATIKE (DIM)

Kandidati duhet:

1. Të zotërojë Diplomë Universitare (Diplomë e Integruar / Master i Shkencave (3+2)) në Matematikë ose Inxhinieri Matematike;
2. Të kenë notë mesatare të paktën 8 (tetë) (për ciklin e studimit (3+2), nota mesatare për të dy ciklet e studimit);
3. Të ketë përvojë akademike dhe mësimdhënieje;
4. Të ketë kulturë komunikimi dhe aftësi për të punuar në grup;
5. Të mos ketë penalitete në lidhje me figurën e tij si mësimdhënës;

Bëhet përjashtim për pikën 1 dhe 2 në raste tepër të vecanta kur kërkohen pedagogë në lëndë me kërkesa specifike

Preferohen kandidatët që kanë gradën “Doktor” apo Tituj Akademike



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

Renditja e Kriteve vlerësuese:

1. Titulli Akademik Profesor, titulli Akademik Profesor i Asociuar, Grada Shkencore Doktor, Docent
2. Ekselencë dhe rezultatet e kandidatit në programet e studimit.
3. Eksperiencë pune në mësimdhënie, preferohet stazh pune në Universitetin Politeknik / Universitete ose në shkolla të larta, eksperiencë në procesin e kualifikimit shkencor, eksperiencë në hartimin dhe realizimin e projekteve të ndryshme.
4. Kultura e komunikimit dhe aftësia për të punuar në grup.
5. Aftësitë profesionale dhe akademike në fusha të vecanta sipas nevojave të DIM.

II. DEPARTAMENTI I INXHINIERISË FIZIKE (DIF)

Kandidati duhet:

1. Të zotërojë Diplomë Universitare (Diplomë e Integruar / Master i Shkencave (3+2)) në Fizikë ose Inxhinieri Fizike;
2. Të kenë notë mesatare të paktën 8 (tetë) (për ciklin e studimit (3+2), nota mesatare për të dy ciklet e studimit);
3. Të ketë përvojë akademike dhe mësimdhënieje;
4. Të ketë kulturë komunikimi dhe aftësi për të punuar në grup;
5. Të mos ketë penalitete në lidhje me figurën e tij si mësimdhënës.

Bëhet përjashtim për pikën 1 dhe 2 në raste tepër të vecanta kur kërkohen pedagogë në lëndë me kërkesa specifike

III. DEPARTAMENTI I KIMISË (DK)

Kandidati duhet:

1. Të ketë mbaruar studimet e plota universitare (diplomë e integruar ose ciklet 3+2) në degët Kimi Industriale ose Kimi e Përgjithshme



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

2. Të ketë mesatare mbi 8, ndërsa mesatarja e notave të lëndëve të kimisë të jetë jo më e ulët se 8.5.
3. Preferohet të ketë përvojë në mësimdhënie dhe punën në laborator, të paktën 2 vjet.
4. Pasja e gradave dhe titujve përbën përparësi.

IV. QENDRA E GJUHËVE TË HUAJA (QGJH)

Kandidati duhet:

1. Të kenë mbaruar studimet në një program studimi në fushën e gjuhës angleze, gjuhë letërsi shqipe, (sistemi i vjetër ose i ri 3+2);
2. Të kenë mesataren e dy cikleve të studimit apo me program të vjetër studimi me notë mesatare të paktën 8.00;
3. Të kenë përvojë akademike dhe mësimdhënieje;
4. Preferohen kandidatët që kanë gradën “Doktor” apo tituj akademikë;
5. Të ketë kulturë komunikimi dhe aftësi për të punuar në grup;
6. Të mos ketë penalitete në lidhje me figurën e tij si mësimdhënës.



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

DOKUMENTACIONI

Kandidatët që kandidojnë për herë të parë duhet të paraqesin dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Jetëshkrimi (CV);
3. Fotokopjo e dokumentit të identifikimit;
4. Fotokopjo e diplomës universitare dhe listës së notave të noterizuar (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njësimi nga Ministria e Arsimit);
5. Formular vetëdeklarimi, sipas modelit të UPT-së;
6. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton tituj dhe gradat, trajnime, kualifikimet, arsimin shtesë (nëse ka);
7. Vërtetim nga Qendra e Punës / Deklaratë që nuk është në mardhënie pune.

Kandidatët që kanë bashkëpunuar me FIMIF gjatë vitit akademik 2021-2022 apo gjatë viteve akademike të mëparshme, duhet të paraqesin dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Jetëshkrimi (CV) rifreskuar;
3. Formular vetëdeklarimi sipas modelit të UPT-së;
4. Vërtetim nga Qendra e Punës / Deklaratë që nuk është në mardhënie pune.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet pranë secilit departament, në periudhën **26.09. 2022 – 07. 10. 2022**, nga ora **8.00 – 16.00**